



**Republika e Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Shërbimi Gjeologjik i Kosovës**



**Republika e Shqipërisë
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

Ndërmjet

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës

përfaqësuar nga

SHËRBIMI GJEOLGJIK I KOSOVËS

dhe

Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë

përfaqësuar nga

SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR

Duke shprehur vullnetin e përbashkët të dy institucioneve për bashkëpunim në frymën e partneritetit,

Duke respektuar legjislacionin e të dyja vendeve.

Duke krijuar mundësi për bashkërendimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, palët nëpërmjet këtij memorandumi shprehin vullnetin për bashkëpunim në fusha të ndryshme të shkencave të Tokës.

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi lidhur me realizimin e projekteve shkencore dhe atyre aplikative në përputhje me legjislacionin dhe strategjitë zhvillimore të të dy vendeve përmes:

- 1.1 Shkëmbimit përvojave shkencore dhe aplikative në gjeoshkencë;
- 1.2 Koordinimit të veprimtarisë për pajisje me teknologji bashkëkohore në interes të dy institucioneve;
- 1.3 Koordinimit për angazhim të përbashkët të aktiviteteve rajonale dhe me gjërë, si dhe
- 1.4 Ndhmës dhe bashkëpunimit reciprok për ngritjen dhe aftësimin e kapaciteteve njerëzore.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në këto fusha:

- 1.1 Pjesëmarrje në hartimin e projekteve kapitale me angazhim të drejtpërdrejtë sipas fushave përkatëse;
- 1.2 Shkëmbimi i informacioneve dhe arritjeve shkencore;
- 1.3 Organizimi i tryezave të përbashkëta shkencore si konferenca, simpoziume, seminare dhe angazhim për kontribute të përbashkëta në aktivitetet shkencore ndërkombëtare;
- 1.4 Pjesëmarrje e përbashkët në konsorciumet e projekteve dypalëshe dhe ndërkombëtare.

Neni 3 Konfidencialiteti

Palët bien dakord që të gjitha materialet dhe informacionet e shkëmbyera, do të përdoren për qëllime të interesit të përbashkët dhe do t'i nënshtrohen parimit të konfidencialitetit, kur kjo është e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi të të dyja vendeve.

Neni 4
Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet eventuale lidhur me këtë memorandum, palët do t'i zgjidhin përmes mirëbesimit reciprok.

Neni 5
Ndryshimi/Plotësimi

Palët me marrëveshje mund ta ndryshojnë apo plotësojnë këtë memorandum, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në shtetin përkatës.

Neni 6
Zbatimi

Palët bien dakord se do të përkujdesen për zbatimin e këtij memorandumit me përkushtim, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e autoriteteve të tjera përkatëse nga dy palët.

Neni 7
Gjuha

Ky memorandum është hartuar në gjuhët zyrtare të të dyja vendeve dhe nënshkruhet nga të dy palët në dy kopje.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Memorandumi i Mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe mbetet në fuqi deri në momentin kur palët nënshkruese vendosin ta ndërpresin atë.
2. Ndërprerja bëhet pas njoftimit paraprak me shkrim prej gjashtë (6) muajsh, nga njëra prej palëve.
3. Megjithë ndërprerjen, palët janë të detyruara t'i përmbushin me korrektësi të plotë detyrimet që kanë lindur nga bashkëpunime dhe angazhime të bazuara në këtë memorandum, por që zgjasin në afat kohor përtej përfundimit të Memorandumit të Mirëkuptimit.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Republikës së Kosovës


SHËRBIMI GJEOLGJIK I KOSOVËS



Fidaim Sahiti
Kryeshef Ekzekutiv

Ministria Energjisë dhe Industrisë së
Republikës së Shqipërisë

SHËRBIMI GJEOLGJIK I SHQIPËRISË



Viktor Doda
Drejtor i Përgjithshëm

Lidhur me datë: 12 / 12 / 2016 në Prishtinë